



USAID | **ALBANIA**
FROM THE AMERICAN PEOPLE

PRESS RELEASE

Për shpërndarje të menjëhershme:

17 qershor 2010

Për më shumë informacion:

Kontakti: Zj.Silvana Meko

Zyrë: +355-4-2278-121

Cel: 0694033831

Email: smeko@lgpa.al

<http://albania.usaid.gov>

www.lgpa.al

Sistemi i ri i taksave në Elbasan dhe Gramsh përmirëson shërbimet publike

ELBASAN / GRAMSH, 17 QERSHOR 2010 Kryetaret e Bashkive Elbasan dhe Gramsh, përkatësisht Qazim Sejdini dhe Kastriot Zera, dhe përfaqësuesi i USAID, Stephen Herbaly, përruan sot një sistem të ri të kompjuterizuar të taksave vendore në të dyja qytetet. Sistemet e programit që u zhvilluan nëpërmjet Programit të USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA), mundësojnë një administrim më të efektshëm dhe më efikas të vjeljes së taksave dhe ofrimit të shërbimeve që do të rezultojnë në të ardhura më të mëdha nga taksat për bashkitë dhe në shërbime më të mira për qytetarët.

Deri tani, Drejtoria e Taksave në Bashkitë e Elbasanit dhe Gramshit i kryente funksionet në mënyrë manuale. Me sistemin e ri të kompjuterizuar, drejtoria e taksave do të ulë kohën që duhet për të llogaritur saktësisht detyrimet tatimore dhe evidentojnë pagesat e taksave. Sistemi gjithashtu lejon zyrtaret e urbanistikës të hartojnë raporte të rëndësishme si dhe do të analizojnë të ardhurat nga taksat për planifikimin dhe zhvillimin e qytetit në të ardhmen. Gjithashtu, do të pakësojnë ndërveprimet personale me punonjësit e tatimeve që shpesh konsiderohen si burim i praktikave korruptive.

Deri tani, LGPA / USAID ka përruar në 8 bashki sistemet e reja të kompjuterizuara të taksave vendore, që përfshijnë bashkitë e Lezhës, Fierit, Fushe-Krujës, Korçës, Pogradecit, Shkodrës, Elbasanit dhe Gramshit. Në total, mbështetja e USAID-it për kompjuterizimin e drejtorive të taksave shkon në shumën mbi 370 milion lekë në 10 departamente të taksave të bashkive, përfshirë bashkinë e Elbasanit që arrin vlerën afërsisht 1.9 milion Lekë dhe mbi 2.5 milion Lekë në bashkinë e Gramshit.

Në Elbasan, sistemi i ri i kompjuterizuar i taksave ndodhet në të njëjtën godinë me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL), duke krijuar një one-stop shop për bizneset vendore. Në të njëjtin vend, tani bizneset mund të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, të aplikojnë për licenca në Qendrën Kombëtare të Licencimit dhe të regjistrohen e të marrin informacion nga Departamenti i Taksave në bashki.

Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA) punon me bashkitë partnere në Shqipëri për nxitjen e zhvillimit të ekonomisë vendore, për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe për fuqizimin e pjesëmarrjes dhe angazhimit të së shoqërisë civile dhe të sektorit privat në zhvillimin vendor. Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri asiston në Elbasan, Fier, Fushë-Krujë, Gramsh, Korçë, Kukës, Librazhd, Pogradec dhe Shkodër.

###